

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (KESH SH.A.)
THIRRJE PËR SHPREHJE INERESI

HYRJE

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) është një kompani publike e licensuar nga Enti Rregullator I Energjisë (ERE) për prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike të prodhuar nga asetet gjeneruese që ka nën administrim.

Modeli aktual i Tregut të Energjisë Elektrike, i miratuar nga ERE, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 620, datë 22 Tetor 2021 për; “Miratimin e kushteve të Detyrimit të Furnizimit Publik (DFP) për të licensuarit e Sektorit Energjitik Shqiptar, gjatë periudhës së gjëndjes së jashtëzakonshme të furnizimit me energji, për të parandaluar dhe përballuar pasojat e krizës globale të energjisë” e ngarkon KESH sh.a. me detyrimin që të sigurojë të gjithë energjinë e nevojshme për të përmbushur nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU). Për përmbushjen e këtij detyrimi, KESH duhet të përdorë së pari energjinë e prodhuar nga asetet e veta gjeneruese duke e kombinuar me marrëveshje shkëmbimi apo depozitimei, dhe në rast të mosplotësimit të kërkesës së FSHU, të blejë pjesën tjetër në tregun e parregulluar.

Përmbushja e DFP në kushtet e krizës globale energjitike të shoqëruar me ngritjen e menjëhershme të çmimeve të energjisë në tregjet rajonale si dhe varësia e prodhimit të energjisë nga kushtet hidro meteorologjike, e vendos KESH në një trysni jo të zakonshme financiare dhe operationale. Qeveria e Shqipërisë u angazhua në mbështetje të KESH sh.a. për përmbushjen e DFP me kosto sa më të ulët, dhe për minimizimin e pasojave të çmimeve të rritura dhe të paparashikueshme të energjisë në tregjet rajonale.

Nëpërmjet VKM Nr. 757, datë 21 Dhjetor 2021, për “Disa ndryshime në VKM Nr. 620, datë 22 Tetor 2021”, Qeveria e Shqipërisë autorizon KESH sh.a., që në përputhje me nevojat dhe mundësitë që do të paraqiten, ti drejtohet tregut ndërkombëtar për të marrë përkohësisht (1-2 vjet) me qera asetet gjeneruese termike shtesë, të cilat mund të instalohen dhe lidhen lehtësisht me Rrjetin e Transmetimit të Energjisë në Shqipëri,

I. KËRKESA PËR SHPREHJEN E INTERESIT

E ndodhur në rrethanat dhe detyrimet ligjore të sipërpërmendura, KESH sh.a., me qëllim që të zbulojë mundësitë teknike dhe ekonomike për marrjen me qera të një asemi gjenerues termik, i instalueshëm dhe i trupëzueshëm lehtësisht me rrjetin e transmetimit të energjisë, ndërmerr procedurën:

Thirrje për Shprehje Interesi për dhënie me qera të një asemi gjenerues termik.

Në përfundim të kësaj procedure, KESH sh.a, shpreson të kontraktojë një kompani ndërkombëtare, ose grup kompanish, që do të paraqesë ofertën më të ulët të pranueshme për dhënien me qera, për një periudhë të përkohëshme (2 vjet), të një asemi gjenerues termik të trupëzuar me rrjetin shqiptar të transmetimit të energjisë, duke realizuar, nën përgjegjësinë e vet, aktivitetet për operimin dhe mirëmbajtjen (O&M) e asemi gjatë gjithë periudhës së qiradhënies dhe në përputhje me kërkesat e paraqitura për shfrytëzimin e tij nga ana e KESH sh.a.